



GROUP FOR LEGAL  
AND POLITICAL  
STUDIES

2 tetor, 2017

**Nga:** Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)  
Instituti për Studime të Avancuara (GAP)  
Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS)

**Për:** Kryeministrin e Republikës së Kosovës z. Ramush Haradinaj

**Lënda:** Kërkesë për rishqyrtimin e vendimit për zbatimin e pjeshëm të Opinionit të Agjencisë Kundër Korrupsionit për depolitizimin e bordeve të ndërmarrjeve publike.

---

I nderuar Kryeministër,

Vendimi juaj i 29 shtatorit 2017 për shkarkimin e dhjetë drejtorëve të bordeve të ndërmarrjeve publike nuk mirëpritet e as mbështetet nga ne, tri organizatat joqeveritare, për një sërë arsesh siç vijon:

1. Ky vendim paraqet zbatim selektiv të ligjit dhe të opinionit të Agjencisë Kundër Korrupsionit.
2. Sikur ky vendim ta kishte për qëllim zbatimin e ligjit, do të pasonte faza e emërimit nëpër këto pozita të anëtarëve të tjerë nga Listat Rekomanduese, ashtu siç e kërkon ligji.
3. Pjesë e këtij vendimi janë anëtarë të një organi i cili nuk është më nën përgjegjësinë e Qeverisë, por të Kuvendit të Kosovës dhe është vetëm Kuvendi ai që mund t'i shkarkojë këta drejtorë. Për këto arsye, e kundërshtojmë këtë formë selektive të zbatimit të ligjit dhe kërkojmë marrjen e vendimeve që çojnë deri në fund zbatimin e së drejtës.

Më 29 shtator 2017, ju morët vendim për shkarkimin e disa anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike. Ky vendim është marrë në bazë të shkresës që ka pranuar Zyra e Kryeministrit nga Agjencia Kundër Korrupsionit me numër protokollit 462 të datës 22.02.2016, nëpërmjet së cilës është rekomanduar që të merren masa ndaj personave që janë emëruar nëpër Borde të Ndërmarrjeve Publike, në kundërshtim me dispozitat ligjore. Ndërkaq, kjo kërkesë u paraqit pas inicimit të hetimit nga institutet INDEP, GAP dhe GLPS lidhur me politizimin e bordeve të ndërmarrjeve publike. Në të njëjtën linjë, ky vendim juaji është marrë edhe në bazë të Dokumentit ERA (Agjenda për Reforma Evropiane) që është aprovuar në Qeveri dhe është

proceduar në Kuvend vitin e kaluar. Pra, sipas këtij dokumenti, konkretisht kërkohet që: “Qeveria zotohet të veprojë sipas rekomandimevetë lëshuara nga Agjencia Kundër Korrupsionit.”.

Megjithatë, përtej titullit të tij si lajm, përmbajtja nuk qe shpresëdhënëse për të ardhmen e ndërmarrjeve publike. Para se t’i arsyetojmë vërejtjet ndaj këtij vendimi dhe rrjedhimisht kërkesat; na lejoni t’jua rikujtojmë zhvillimin e këtij problemi. Në shkurt të vitit 2015, Qeveria e Kosovës pati hapur konkurs për 15 vende të lira në bordet e ndërmarrjeve publike. Mbi 1800 kandidatë kishin aplikuar në mënyrë të rregulltë. Një pjesë e kandidatëve binin ndesh me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike. Më saktësisht, ata nuk ishin ligjërisht të pavarur për t’i marrë këto poste pasi ata ose mbanin poste udhëheqëse në parti politike, ose kishin kandiduar për poste të zgjedhura në tre vitet e fundit, dispozitë përjashtuese kjo për pozitat respektive, sipas nenit 17.2 (k) të këtij ligji.

Vendimet për emërimin e anëtarëve të bordeve filluan të dalin në shtator dhe tetor të po atij viti, 2015. Ne, institutet INDEP, GAP dhe GLPS kundërshtuam menjëherë shkeljet e dukshme të ligjit dhe i kërkua Qeverisë së atëhershme që t’i anulojë menjëherë vendimet e paligjshme. Kur kjo nuk ndodhi, përkundrazi më shumë vendime të paligjshme për emërimet dolën, ne informuam ambasadat e Quint-it, zyrën e komisionarit për zgjerim Hahn dhe mediat. Për më tepër, deponuam një kallëzim në Agjencinë Kundër-Korrupsionit dhe bashkëpunuam me departamentin e hetimeve dhe u ofruam gjithë materialin nga puna jonë kërkimore.

Një vit pasi ishte hapur konkursi, 15 shkurt 2016, Agjencia Kundër-Korrupsion kishte vendosur ta publikonte Opinionin Ligjor numër AKK-DLK-3113/15 që vërtetonte plotësisht pretendimet tona. Madje, Agjencia i kishte dhënë vërejtje Zyrës së Kryeministrit që në thirrjen për konkurs nuk ka precizuar kërkesat ligjore, qartësisht të theksuara në Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Pra, faktet janë këto, i nderuar Kryeministër:

- 19 persona janë emëruar në kundërshtim flagrant me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike
- Këta persona, gjatë procesit të aplikimit kanë nënshkruar një Deklaratë nën Betim duke pretenduar se nuk ishin në kundërshtim me Ligjin. Neni 15.3 i Ligjit parashikon gjobë deri në 10 mijë euro për deklaratë të rrejshme nën betim.
- Agjencia Kundër-Korrupsion vërtetoi pretendimet tona dhe e njëjta agjenci gjeti fajtorë Zyrën e Kryeministrit për dështim në organizimin e konkursit sipas ligjit.
- Zyra e Komisionerit Johannes Hahn, përfaqësuesit diplomatik, Agjenda Evropiane e Reformave, disa raporte radhazi të Komisionit Evropian dhe ne, dhjetra e qindra organizata joqeveritare vendore kemi kërkuar depolitizim të plotë dhe vendosje të standardit të ligjshmërisë së plotë.

Do të ishte shpresëdhënës një vendim i tillë, po që se do zbatonte plotësisht ligjin. Ndonëse ju keni vendosur ta merrni parasysh pjesërisht opinionin e Agjencisë Kundër-Korrupsionit, ky opinion kërkon qartazi vënie të ligjshmërisë, që nënkupton vënie të ligjshmërisë së plotë dhe për të gjithë. Për shembull, nëse do t'i ndiqnit udhëzimet ligjore, do të duhej që krahas shkarkimit të 19 personave në fjalë, të emëronit zëvendësimin e tyre nga listat rekomanduese që janë përpiluar nga aplikimet e mbi 1800 kandidatëve. Neni 15 i Ligjit e thotë shprehimisht:

*Nëse një anëtar i një Bordi të NP nuk është në gjendje që ta përfundojë mandatin e tij/saj, pasardhësi do të zgjidhet nga Qeveria (i) nga lista e kandidatëve e cila e fundit i është propozuar nga Komisioni Rekomandues ose, (ii) nëse asnjë kandidat i këtillë nuk është në dispozicion, në përputhje me procedurën e përcaktuar më sipër.<sup>1</sup>*

Përveç kësaj, vendimi juaj për shkarkimin e këtyre anëtarëve të bordeve, në një rast rast paraqet edhe ndërhyrje në kompetencat e Kuvendit. Kështu, si pjesë të listës suaj të shkarkuarve janë edhe anëtarë të bordit të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT). Jua rikujtojmë, z. Kryeministër, pasi që këtë ju duhet ta dini, që me miratimin e pakos së tretë të legjislacionit në fushën e energjisë vitin e kaluar, aksionar i KOSTT është Kuvendi i Kosovës i cili emëron dhe shkarkon anëtarët e bordit të KOSTT. Në këtë kuptim, i nderuar Kryeministër, shkarkimi i anëtarëve të KOSTT paraqet ndërhyrje në kompetencat e Kuvendit të Kosovës dhe mund të jetë i dëmshëm për pavarësinë e operatorit dhe pozitën e tij në një treg që tashmë ka filluar të liberalizohet.

Edhe në këtë pikë, Ligji është i qartë dhe kushtëzon edhe Kuvendin se kur mund ta bëjë këtë shkarkim:

*Të drejtat e aksionarit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit ushtrohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. (Neni 13.2)*

*Kuvendi i Kosovës mund të nisë procedurën për shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve të Bordit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit kur, pas 2 (dy) vjetëve të njëpasnjëshme të rishikimit të performancës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Komisioni Funkcional gjen se:*

*6.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka arritur të dëshmojë se plotësisht dhe në mënyrë aktive ka zbatuar funksionet dhe detyrat sipas ligjeve që rregullojnë sektorin e energjisë në Kosovë; dhe*

*6.2. dështimi i tillë i zbatimit ka dëmtuar seriozisht funksionimin efikas, efektiv dhe të pavarur të sistemit të operimit të Transmetimit.<sup>2</sup>(Neni 13.6)*

<sup>1</sup>Republika e Kosovës, (2012), Ligji Nr.03/L-087 përNdërmarrjetPublike, Neni 15.8, Zgjedhja e Drejtorëvetë NP, Prishtinë: GZRKS, i qasshëmnë<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547> (qasur në shtator, 2017).

<sup>2</sup>Republika e Kosovës, (2016), LigjiNr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, Neni 13, Qeverisja korporative, kompetencat, raportimi, i qasshëm në<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12744> (qasur në shtator, 2017).

E, për të dëshmuar që njëmend e keni për qëllim t'i depolitizoni bordet, do të duhej që në këtë vendim tuajin t'i përfshihet edhe anëtarët e bordeve që aktualisht, në kundërshtim flagrant me ligjin, janë duke kandiduar për anëtarë të asambleve komunale. Për shembull, nuk besoj se do të ju zë në befasi lajmi që anëtari i bordit të Trainkos është bartës i listës së kandidatëve të Partisë Demokratike të Kosovës për Asambleenë komunale të Gllgovcit, **Labinot Halilaj**. Me vendimin tuaj, ju keni mundur që jo vetëm të përmirësonit një shkelje të bërë para dy vitesh, por edhe të parandalonit një shkelje që po ndodhë.

I nderuar Kryeministër,

Agjencia Kundër-Korrupsion, Agjenda Evropiane e Reformave, Raportet e Komisionit Evropian për Kosovën dhe ne si organizata të shoqërisë civile që kemi kontribuar në këtë drejtim, nuk kemi insistuar për depolitizim të pjesshëm, por të plotë. Nuk jemi përpjekur që të citohejmë për të legjitimuar zbatim selektiv të ligjit që nuk do të garantojë pavarësi të ndërmarrjeve publike. Si organizata të shoqërisë civile, jemi të gatshme t'ju ndihmojmë me çkado që mundemi në qoftë se qëllimi juaj i vërtetë është zbatimi i ligjit, depolitizimi i ndërmarrjeve publike dhe vendosja e standardit të ligjshmërisë që do të garantonte performancë më të mirë të këtyre ndërmarrjeve, do ta rrisë besimin në ju dhe qeverisjen tuaj dhe pa dyshim, do të jetë arritje e shkëlqyer e agjendës evropiane. Që të jetë e tillë, ky vendim i juaji ka nevojë të rishikohet dhe të plotësohet rrënjësisht.

Sinqerisht,

INDEP, GAP dhe GLPS